



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:153928

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05489216

P.nr. 86/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL,

gjqitari i vetëm gjykues Njazi Morina, me bashkëpunëtoren profesionale Hajrije Krasniqi, në lëndën penale kundër të akuzuarve: B. H. nga fshati B., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale ngacmim seksual nga neni 183 par. 1 lidhur me par.2 të KPRK-së dhe B.K. nga fshati N., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë me numër PP/II.nr. 1058/2022 të datës 11.07.2023 në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 31.01.2024, në prezencën e prokurorit të shtetit Anton Hasanaj, e dëmtuara V. B., i akuzuari B. H., së bashku me mbrojtësen e tij Liri Krasniqi, avokate në Malishevë dhe i akuzuari B.K., **më 05 shkurt 2024, nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

I akuzuari **B. H.** i lindur më në fshatin B., Komuna e Malishevës, nga i ati E. dhe e ëma S., e gjinisë G., i martuar atë i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i dënuar më parë, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuari **B. K.** i lindur më ... në fshatin N., Komuna e Malishevës, me vendbanim në Prishtinë, në rrugën Mati 1, Rr "M.m F.a", Kompleksi N.T., nr...., nga i ati R. dhe e ëma H., e gjinisë P., i martuar atë i 2 fëmijëve, ka të kryer Fakultetin e Ndërtimtarisë në UP, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar më parë, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I.

I akuzuari B. H..

I. DISPOZITIVIT PJESA PËRSHKRUESE.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE,

Më datën 16.06.2022 rreth orës 20:00/h, në Rr. "A. K." në Malishevë, saktësisht tek marketi "V. F. S.", për qëllime seksuale pa pëlqimin e saj, e prek personin tjetër dhe atë të dëmtuarën V. B. me qëllim të cenimit të dinjitetit të saj duke krijuar mjedis objektivisht degradues dhe poshtërues, në atë mënyrë që derisa e dëmtuara ishte duke dalur nga marketi, aty për një moment i afrohet i pandehuri B. i cili fillon që ta prekë në pjesën e pasme të trupit në vithe duke i thënë "o sa b. e mire, si dhe duke ia bërë me sy dhe lëvizje të buzëve", pastaj e dëmtuara i drejtohet me fjalët "a je normal bre ti" dhe largohet nga ai.

- me çka ka kryer veprën penale ngacmimi seksual nga neni 183 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së.

I a. DISPOZITIVIT PJESA URDHËRUESE E DËNIMIT.

Gjykata konform nenit 4,6,7,17,38,39,40,42,46,47,48,49,69,70,183 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së, si dhe nenit 241,242,364,365 të Kodit të Procedurës Penale, të njëjtin e gjykon me:

DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarin **B.H.** e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej shtatë (7) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej një (1) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I b. DISPOZITIVI PJESA URDHËRUESE E MASËS.

GJYKATA duke u bazuar në nenet 18 par. 2,84 par. 1 nën par. 1.2, 86 par. 1 nën par 1.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 513 dhe 515 të Kodit të Procedurës Penale, të akuzuarit krahas dënimit të shqiptuar si më lartë, i shqipton edhe:

MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUAR PSIKIATRIK NË LIRI NË INSTITUCIONIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR NË QENDRËN E SHËNDETIT MENDOR NË GJAKOVË

I. OBLIGOHET i akuzuari **B. H.**, që t'i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, në momentin e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe të paraqitet në Qendrën e Shëndetit Mendor në G., sipas kohës, terminëve dhe rekomandimit të mjekëve-eksperteve të psikiatrisë, gjithashtu të përdor terapinë sipas rekomandimit të ekspertëve.

II. KJO MASË do të ekzekutohet në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor në Qendrën e Shëndetit Mendor në Gj., i cili obligohet që ta pranoj të akuzuarin **B. H.** për trajtim të

detyruar psikiatrik në liri dhe kohë pas kohe ta njoftoj gjykatën mbi gjendjen dhe suksesin e trajtimit të tij dhe atë së paku një herë në tre muaj, si dhe ta njoftoj gjykatën për çdo vështirësi në trajtim.

III. MASA e trajtimit të detyruar psikiatrik në liri nuk është e kufizuar në kohë. Kjo masë do te zgjasë për aq kohë sa i akuzuari **B. H.**, do të këtë nevojë për trajtim, e derisa të ekzistojnë kushtet mbi të cilat është caktuar kjo masë, por jo më tepër se tri vite.

IV. OBLIGOHET Shërbimi Sprovues i Kosovës, Zyra Regjionale në Gj., që të bëjë verifikimin e ekzekutimit të kësaj mase.

V. Në rast të mosrespektimit të kësaj mase nga i akuzuari, Gjykata mund të vendos për ndërrimin e masës - shqiptimin e masës së trajtimit të detyruar psikiatrik me ndalim.

VI. OBLIGOHET Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në M., që t'ia sigurojë te gjitha barnat e nevojshme te cilat ia cakton Qendra e Shëndetit Mendore në Gj., te pandehurit **B. H.**, gjate kohës sa është **nen MASE**, ta bartin me automjet te pandehurin **B. H.**, nga shtëpia e tij në Qendrën e Shëndetit Mendore në Gj. dhe anasjelltas, sa here t'ia cakton vizitat mjekësore Qendra e shëndetit Mendore në Gj.. **KY OBLIGIM VLEN DERI SA TE JETE NË FUQI KJO MASE.**

VII. ME KËTË AKTVENDIM njoftohet Qendra për Punë Sociale në M..

VIII. Kjo masë e trajtimit është caktuar/shqiptuar, pasi që i akuzuari është diagnostikuar me sëmundje mendore i cili vuan nga çrregullim organik i personalitetit, çrregullim ky i cili në klasifikimin ndërkombëtar të sëmundjeve (ICD – 10) kodohet me shifrën me F 07.0.

IX. Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 20 €, si dhe për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 30 €, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara V. B.a nga P. L. e s., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

II.

I akuzuari B. K..

ËSHTË FAJTOR

SEPSE,

Më datën 16.06.2022 rreth orës 20:00/h në Rr. "A. K." në Malishevë, saktësisht tek marketi "V.F. S.", me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit B.H., në

atë mënyrë që natën kritike pasi që i dëmtuari e kishte ngacmuar seksualisht bashkëshorten e të pandehurit, ky i fundit derisa ishte duke dalur nga marketi se bashku me gruan dhe fëmijët e tij, për një moment në dalje të marketit e dëgjon gruan duke bërtitur në drejtim të dëmtuarit, ashtu që i pandehuri B. shkon pas të dëmtuarit të cilin fillimisht e kap për dore e më pas e godet me grusht në pjesën e nofullës nga ana e djathtë ku i njëjti nga goditja bie në tokë, me ç' rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruara si në ekspertizën mjeko ligjore të dr. A. G., datë 23.09.2022.

- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,6,7,17,38,39,40,42,46,47,48,49,69,70,185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, dhe nenit 241,242 dhe 365 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton,

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i pandehuri **B. K.** dënohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhë prej një (1) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 20,00 €, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 30,00 €, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzë PP/II.nr. 1058/2022, të datës 11.07.2023, kundër të akuzuarve: B. H. nga fshati B., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale ngacmim seksual nga neni 183 par. 1 lidhur me par.2 të KPRK-së dhe B. K. nga fshati N., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor më 31.01.2024, pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit Anton Hasanaj, të pandehurve iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohen të pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurve se ndjehen fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohen nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga të pandehurit pasi që është bindur plotësisht se ishin të vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaron: me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve është vërtetuar në tersi gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë ku edhe formohen të gjitha elementet e veprave penale me të cilat ngarkohen. Gjykatës i propozojë që të akuzuarit ti shpallë fajtorë dhe ti shqiptojë nga një dënim meritor konform ligjit duke i vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, gjithashtu propozojë që ndaj të pandehurit B. H. ti shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri e cila do të ekzekutohet në Qendrën e Shëndetit Mendor në Gj. bazuar në ekspertizën psikiatrike të përpiluar nga IPFK të datës 07.11.2022.

E dëmtuara V. B. në fjalën përfundimtare deklaron: unë kërkoj që të dënohet i pandehuri B. H.me një dënim maksimal, kërkoj që mos të ndodhin këto sene, kërkoj kompensim dëmi.

I pandehuri B. H., në fjalën përfundimtare deklaron: unë pajtohem me çka tha avokatja ime, i kërkoj falje të dëmtuarës dhe bashkëshortit të saj, publikisht dhe familjarisht pasi që unë nuk jam vetvetja, jam gjithmonë me terapi te mjeku, kur ka ndodhur aksidenti në fund të vitit 2008, këtë kërkim falje e kërkoj në mënyrën më të sigurtë, i premtoj gjykatës po ashtu edhe të dëmtuarës se nuk do ti sjelli probleme asnjëherë, jo vetëm këtyre po askujt tjetër. Unë jam i pa punë pasi që jam me vendim të pensionit të personave pa aftësi të përhershme.

Mbrojtësja e të akuzuarit B.H. avokate Liri Krasniqi në fjalën përfundimtare deklaron: pas konsultimeve të mjaftueshme me të akuzuarin B. H. i njëjti në mënyrë vullnetare pranoj fajin për veprën penale që i bije në barrë, shpreh keqardhje për rastin që ka ndodhë, i njëjti kërkon falje edhe palës së dëmtuar, shpreh keqardhje për veprimet e veta pasi që i njëjti deklaron se nuk ka qenë vetvetja në ato çaste. Po ashtu bashkëshortja e tij se i njëjti përdor terapi dhe i njëjti është i sëmur nga një kohë të gjatë nga aksidenti që ka pasur, andaj i propozojmë gjykatës që të njëjtit ti shqiptoj masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

I pandehuri B.K. në fjalën përfundimtare deklaron: ky është rasti im i parë, i premtoj gjykatës që nuk do të përsërisë vepër tjetër penale.

Nga thëniet e vet të pandehurve në shqyrtimin gjyqësor u vërtetua se të njëjtit me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tyre kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: raporti fillestar i incidentit nr. ... dt. 16.06.2022; raporti i policit D. K. ID ..., nr. ... dt. 16.06.2022; procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarën V. B., nr. ... dt. 16.06.2022 e dhënë në Stacionin Policor në M.; procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin B.H., nr. ... dt. 16.06.2022 e dhënë në Stacionin Policor në M.; procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin B. K., nr. ... dt. 16.06.2022 e dhënë në Stacionin Policor në M.;

procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitaren A. H., nr. ... dt. 17.06.2022 e dhënë në Stacionin Policor në M.; akt ekspertimi mjeko-ligjor i ekspertit Dr. A. G. i datës 23.09.2022; raportet mjekësore me numër të protokollit ...të datës 16.06.2022, të lëshuar nga Shërbimi Urgjent- QKMF M. në emër të dëmtuarit B. H.; raporti mbi gjendjen e shëndetit mendor për të pandehurin B.H., i përpiluar nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës i datës 07.11.2022; CD-video incizimi nga kamerat e sigurisë të datës 16.06.2022, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga të pandehurit ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarin e pranimit të fajësisë nga të pandehurit dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprave penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprave penale që kanë kryer të pandehurit, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarin e pranimit të fajësisë nga të pandehurit e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që posaçërisht rrethanë lehtësuese për të pandehurin e parë ka marr faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, të njëjtën e ka pranuar në mënyrë vullnetare, i kërkoi falje të dëmtuarës, i premtonte gjykatës se nuk do të përsëris vepër tjetër penale, e kur dihet fakti se sipas ekspertizës së Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës ku kanë konstatuar se i pandehuri është me shkallë esenciale të zvogëluar. Kurse për të pandehurin e dytë ka marr faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, të njëjtën e ka pranuar në mënyrë vullnetare, i premtonte gjykatës se nuk do të përsëris vepër tjetër penale, ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata gjeti se i akuzuari ka qenë edhe më parë i dënuar nga kjo gjykatë dhe atë: i dënuar me kusht 2 muaj brenda 1 viti sipas lëndës P. nr. 127/2009, neni 297, i formës së prerë më 25.05.2010. Të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimin të parapara me nenin 70 të KPRK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se të akuzuarit kanë kryer veprat penale të përshkuara në dispozitiv të këtij aktgjykimit, të akuzuarin B. H. e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, krahas dënimin të pandehurit Gjykata i shqiptoj edhe Masën e Trajtimin të Detyruar Psikiatrik në Liri në Qendrën e Shëndetit Mendor në Gj.. Ndërsa të akuzuarin B.K. e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindjen se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimin nga neni 38 të KPRK-së, dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për pjesën dënuese është marre bazuar në nenin 364,365 të Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi për masën është marre bazuar në nenin 18 par. 2,84 par. 1 nën par. 1.2, 86 par. 1 nën par 1.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 513 dhe 515 të Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr bazuar në nenin 452 të KPP-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr. 86/2023, më 05 shkurt 2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh për pjesën e dënimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.